Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana - Ombudsperson institution
Nr./Br./No. KPD 1940/26
Nr. i fq/Br.str/Nr.pg.
Data/Datum/Date: 11/11/2026
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA II

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

lidhur me vizitat në Qendrën Korrektuese në Dubravë

Për: Znj. Donika Gërvalla Schwarz, ministre
Ministria e Drejtësisë

Kopje: Z. Arben Vitia, ministër
Ministria e Shëndetësisë

Z. Ismail Dibrani, drejtor i përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Arsim Sherifi, u.d. drejtor
Qendra Korrektuese në Dubravë

Z. Milazim Gjocaj, drejtor
Departamenti Shëndetësor në Burgje

Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 11 nëntor 2026

Hyrje

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit (në vijim: MKP) ka të drejtë që, në çdo kohë dhe pa paralajmërim paraprak, t'i vizitojë të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, me qëllim të vlerësimit të kushteve të mbajtjes dhe trajtimit të tyre. Në kuadër të ushtrimit të këtij mandati, MKP-ja, gjatë vitit 2026, realizoi katër (4) vizita në Qendrën Korrektuese në Dubravë (në vijim: QKD), përkatësisht më 17 prill, më 7 maj, më 24 korrik dhe më 24 dhe 25 shtator 2026. Këto vizita ishin të karakterit ad-hoc dhe të përgjithshëm.

Qëllimi i vizitës

1. Qëllimi i vizitave ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave themelore të personave të privuar nga liria, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në kuadër të këtyre vizitave, vëmendje e veçantë iu kushtua kushteve të akomodimit dhe trajtimit të personave të privuar nga liria, regjimit të mbajtjes, qasjes në kujdes shëndetësor, ushqimit dhe higjienës, si dhe mundësive për zhvillimin e aktiviteteve dhe vijimin e arsimit. U verifikuan kutitë e ankesave dhe u zhvilluan intervista me të paraburgosur dhe të dënuar, të cilët kishin telefonuar në Institucionin e Avokatit të Popullit (në vijim: IAP), përfshirë intervistimin e personave me lëndime trupore, rastet e të cilëve ishin përcjellë nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve (më tej: DShB). Në mënyrë të veçantë, u diskutua edhe për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të adresuara më herët nga Avokati i Popullit, me qëllim të vlerësimit të masave të ndërmarra nga autoritetet kompetente dhe të progresit të arritur në zbatimin e rekomandimeve. Përveç këtyre, u shqyrtuan edhe aspekte të tjera që lidhen me respektimin dhe garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Përbërja e grupit monitorues

2. Ekipi monitorues përbëhej si në vijim:

- drejtoresha e MKP-së;
- këshilltari juridik për parandalim të torturës;
- këshilltarja-punëtore sociale;
- këshilltarja juridike nga Departamenti për Bashkëpunim, Hulumtim dhe Raportim;
- mjekja e përgjithshme e angazhuar për kohë të caktuar, me mbështetje të UNMIK-ut;
- këshilltari juridik nga Departamenti për Çështje Ligjore dhe Hulumtim.

Bashkëpunimi i autoriteteve me MKP-në gjatë vizitës

3. Gjatë vizitës, personeli i QKD-së dhe personeli i DShB-së i ofroi MKP-së bashkëpunim të plotë. Ekipit, pa vonesa, iu mundësua qasje në të gjitha hapësirat e qendrës dhe iu siguruan të gjitha informacionet e nevojshme për ta kryer detyrën.

4. Gjithashtu, ekipit iu mundësua zhvillimi i bisedave konfidenciale me personat e dënuar dhe të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues apo të personelit shëndetësor.

Informimi për të drejtat e të burgosurve

5. Pas pranimit në institucion korrektues, çdo i burgosur duhet të informohet në kohë dhe në mënyrë të kuptueshme lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij gjatë qëndrimit në institucion. Informimi duhet të bëhet nga personeli kompetent për rregullat e funksionimit të institucionit, si dhe për të drejtat dhe detyrimet që duhet t'i ketë parasysh gjatë kohës së vuajtjes së dënimit.

6. Neni 23 i Udhëzimit Administrativ MD-Nr. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese (Njohja me Rendin Shtëpiak) përcakton obligimin e institucioneve korrektuese që, menjëherë pas pranimit, të sigurojnë kushte që personi i burgosur, në pajtim me ligjin, të njoftohet me shkrim për të drejtat dhe detyrimet që i ka gjatë mbajtjes së dënimit. Personi i dënuar, i cili nuk di shkrim dhe lexim, njoftohet gojarisht dhe, nëse është e mundur, në gjuhën që e kupton[1].

7. Gjatë monitorimit në QKD, u konstatua se në hapësirat e institucionit nuk ishin vendosur njoftime të mjaftueshme dhe të dukshme lidhur me të drejtat e personave të privuar nga liria.

Keqtrajtimi

8. Gjatë vizitave monitoruese në QKD, u zhvilluan intervista konfidenciale me persona të privuar nga liria, me qëllim të vlerësimit të mënyrës së trajtimit të tyre nga personeli korrektues. Shumica e personave të intervistuar nuk raportuan raste të keqtrajtimit dhe deklaruan se trajtimi nga ana e stafit ishte korrekt. Megjithatë, ekipi pranoi disa pohime lidhur me sjelljen e disa zyrtarëve korrektues. Këto pohime kanë të bëjnë kryesisht me përdorimin e tepruar të forcës gjatë intervenimeve, si dhe me sjelljen dhe komunikimin verbal të papërshtatshëm.

9. MKP-ja vizitoi edhe të burgosurit, të cilëve u është shqiptuar masa disiplinore e vetmisë, me ç'rast intervistoi të dënuarit, por nuk mori pohime për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës. Ankesat e tyre kishin të bënin me vendimin për shqiptimin e masës së vetmisë, e cila, sipas tyre, u ishte shqiptuar pa të drejtë.

10. Rregulla e Brendshme - Tretmanët për të Dënuar, neni 26 (Qëndrimi i të burgosurve në vetmi), paragrafi 1, përcakton: *"I dënuari ndaj të cilit është shqiptuar masa disiplinore e vetmisë gjatë kohës së qëndrimit në vetmi i gëzon të drejtat minimale të parapara me dispozitat ligjore në fuqi."*[2]

11. Neni 70, paragrafi 2, i Udhëzimit Administrativ MD-Nr. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, përcakton: *"I dënuari i cili dërgohet në vetmi si masë ndëshkuese duhet të vizitohet nga mjeku menjëherë pas dërgimit. Mjeku i institucionit korrektues është i obliguar që me shkrim, ta njoftoj drejtorin e institucionit korrektues lidhur me gjendjen shëndetësore dhe psikike të dënuarit në vetmi dhe të jep vlerësimin e tij."*[3]

12. Po ashtu, Praktikat Standarde të Veprimit të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve përcaktojnë: *"Për secilin të burgosur të futur në vetmi, mjeku i institucionit ose i deleguari i tij është i obliguar që së paku një herë në ditë, ta vizitoj të burgosurin në qelinë e tij deri në lirim."*[4]

[1] Udhëzim Administrativ MD-Nr. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 23.
[2] Rregulla e Brendshme Tretmanët për të Dënuar, neni 26, paragrafi 1.
[3] Udhëzim Administrativ MD-Nr. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 70.
[4] Praktikat Standarde të Veprimit, Pika 8.

13. Neni 111, paragrafi 1, i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP)[5] përcakton: *"Gjatë ekzekutimit të dënimit disiplinor të vetmisë, personi i dënuar i gëzon të njëjtat kushte higjienike dhe shëndetësore sikurse personat tjerë të dënuar në institucionin korrektues dhe atij i lejohet qëndrim jashtë ambientit të mbyllur së paku një (1) orë në ditë për ajër të pastër dhe për ushtrime."*

14. Ekipi i MKP-së nuk mori ankesa për sa u përket kontrolleve mjekësore, daljes në ajër të pastër apo shkeljes së të drejtave të tjera.

15. Bazuar në të dhënat e administruara nga Qendra Korrektuese në Dubravë (QKD), për periudhën janar–shtator 2026, u evidentuan gjithsej 120 raporte disiplinore, me 183 të burgosur të përfshirë në incidente të ndryshme. Sipas të dhënave të pranuara, u evidentuan 91 raste të shqiptimit të masës "fajtor", 66 raste të shpalljes "jo fajtor", 31 raste të shqiptimit të masës së qortimit, 9 raste të vetmisë me kusht, 7 raste të vetmisë së pezulluar nga stafi mjekësor për shkaqe shëndetësore, 1 rast i humbjes së beneficioneve dhe 2 raste të dënimit me kompensim. Përveç incidenteve ndërmjet të burgosurve, u shënuan edhe 3 raste të sulmeve kundër stafit apo zyrtarëve korrektues nga ana e të burgosurve, për të cilat u zhvilluan procedurat e brendshme hetimore.

Kushtet e banimit për personat e dënuar në QKD

16. Gjatë vizitës në QKD, u vlerësuan kushtet e banimit dhe ato higjieno-sanitare. Kushtet e banimit paraqesin një komponent të rëndësishëm në garantimin e trajtimit human dhe të sigurt të personave të privuar nga liria. Nga monitorimi u konstatua se, në përgjithësi, këto kushte janë të kënaqshme dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

17. Këto kushte u vlerësuan edhe në raport me Rregullat e Nelson Mandelës, të cilat përcaktojnë se hapësirat e akomodimit duhet të plotësojnë kërkesat shëndetësore, duke përfshirë hapësirën e mjaftueshme, ndriçimin, ngrohjen dhe ventilimin, ndërsa pajisjet sanitare duhet të jenë të përshtatshme dhe të pastra, në mënyrë që të sigurohet respektimi i dinjitetit të të burgosurve.[6]

18. Neni 35, paragrafi 1, i LESP-së përcakton: *"Personi i dënuar ka të drejtë në banim që i përgjigjet kushteve bashkëkohore higjienike dhe rrethanave vendore klimatike."*[7]

19. Ekipi i MKP-së gjatë vizitës vlerësoi gjendjen fizike të pavijoneve dhe kushtet infrastrukturore në to, me ç'rast u evidentuan nevoja të ndryshme për renovim dhe përmirësim të kushteve.

20. Në Pavijonin 1 dhe Pavijonin 3 u vërejt se ka nevojë për renovime, kurse në Pavijonin 2, në kohën e vizitës, po realizoheshin renovime. Në Pavijonin 4, gëlqerosja përfundoi në krahët V-1 dhe V-2, ndërsa punimet filluan edhe në krahët e tjerë, mirëpo u ndërprenë për shkak të rritjes së numrit të personave të privuar nga liria. Për sa i përket Pavijonit 5, u vërejt se nevojitet renovimi i plotë i tij, pasi pavijoni është në gjendje të rëndë fizike dhe kushtet e punës për stafin nuk janë në nivelin e duhur. Në krahun V-1, ku vendosen personat e privuar nga liria ndaj të cilëve është shqiptuar masa disiplinore e vetmisë, kushtet fizike

[5] Ligji nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 111, paragrafi 1.
[6] Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme (Rregullat e Nelson Mandelës), Rregullat 13, 14, 15, 16 dhe 17.
[7] Ligji nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 35, paragrafi 1.

kanë nevojë për renovim për shkak të pranisë dhe depërtimit të lagështisë, si dhe të rrjedhjes së ujit nga tubacioni në korridor.

21. Në këtë drejtim, neni 71 i Udhëzimit Administrativ MD-Nr. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese përcakton: *"Qelia e vetmisë duhet të ketë tualet, ujë, lavaman, dritë të mjaftueshme natyrale, shtrat, tavolinë dhe karrige statike."*[8]

22. Në Pavijonin 6 janë realizuar punime të gëlqerosjes në disa dhoma, për shkak të pranisë së lagështisë. Pavijoni 7 ishte tërësisht në proces rinovimi. Punimet po realizoheshin nga persona të privuar nga liria, të cilët, në kohën e vizitës, ishin të angazhuar në vendosjen e pllakave të qeramikës në hapësirat e banjave.

23. Për dallim nga pavijonet e tjera, Pavijoni 8 u rinovua tërësisht. Në këtë pavijon u krye gëlqerosja, u ndërrua ndriçimi dhe në të gjithë krahët u instaluan kamera të sigurisë. Ekipi monitorues vizitoi edhe Spitalin e Burgut, ku vërejti se punimet e rinovimit përfunduan në të gjitha hapësirat dhe ishte planifikuar edhe ndërrimi i të gjitha dyerve.

24. MKP-ja vizitoi edhe Pavijonin Gjysmë të Hapur (PGjH) dhe Pavijonin D, me qëllim të vlerësimit të kushteve të akomodimit, higjienës dhe mirëmbajtjes së hapësirave, si dhe të shërbimeve në dispozicion të personave të vendosur në këto pavijone. Gjatë vizitës nuk u evidentuan parregullsi.

25. Gjatë vizitës në disa pavijone, MKP-ja vërejti se në dhomat ku akomodohen dy ose më shumë persona të privuar nga liria, tualetet nuk kishin dyer, por ishin të ndara nga pjesa tjetër e dhomës vetëm me perde, duke mos siguruar privatësinë e nevojshme.

26. Në këtë drejtim, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (CPT) thekson: *"Në qelitë me më shumë se një person, hapësirat duhet të jenë të ndara plotësisht nga pjesa tjetër e qelisë."*[9]

27. Gjatë vizitës monitoruese në QKD, pranuam ankesa nga disa persona të privuar nga liria lidhur me mungesën e ujit të ngrohtë në disa pavijone. Sipas tyre, furnizimi me ujë të ngrohtë është i pamjaftueshëm për pastrimin dhe ruajtjen e higjienës personale. Gjithashtu, të burgosurit deklaruan se për ngrohjen e ujit vazhdojnë të përdorin pajisje elektrike të improvizuara, të cilat paraqesin rrezik për sigurinë dhe jetën e tyre.

28. MKP-ja konstatoi se personat e privuar nga liria, në përgjithësi, janë të pajisur me dyshekë dhe batanije. Megjithatë, gjatë vizitës pranuam ankesa nga disa të dënuar lidhur me mungesën e dyshekëve dhe jastëkëve cilësorë. Në raportin e fundit të Avokatit të Popullit për Qendrën Korrektuese në Dubravë, të publikuar më 17 shtator 2024[10], është dhënë rekomandim: *"Të burgosurit të pajisen me dyshekë dhe jastëkë cilësorë."*

Kuzhina e QKD-së

29. Në kuzhinën e QKD-së janë të angazhuar gjashtë (6) persona, edhe pse me rregullore parashihet angazhimi i nëntë (9) personave, si dhe i 15–20 të dënuarve, të organizuar në dy ndërrime pune. Të gjithë personat e angazhuar në kuzhinë, përfshirë edhe të burgosurit që

[8]Udhëzim Administrativ MD-Nr. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 71, paragrafi 1.
[9]Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (CPT), Living space per prisoner in prison establishments: CPT standards, CPT/Inf (2015) 44, 15 dhjetor 2015, paragrafi 10.
[10]https://oik-rks.org/2024/12/02/avokati-i-popullit-raport-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-lidhur-me-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave-3/

janë drejtpërdrejt të përfshirë në përgatitjen e ushqimit, pajisen me libreza sanitare, të cilat kanë vlefshmëri prej gjashtë (6) muajsh. Gjatë vizitës, MKP-ja u njoftua se librezat sanitare ndodheshin në administratë dhe ishin brenda afatit të vlefshmërisë.

30. Sipas listës së verifikuar, rreth 23 të burgosurve u ofrohet ushqim dietal. Përveç përgatitjes së ushqimit pa kripë dhe pa yndyrë, këtyre të burgosurve u ofrohen edhe bukë integrale, si dhe pemë e perime të freskëta sezonale.

31. Gjatë vizitës u konstatua se në ambientet e kuzhinës nuk janë realizuar ndërhyrje infrastrukturore apo rinovime. U vërejt se gjatë reshjeve të shiut pikon ujë nga tavani, konkretisht mbi pjesën ku janë të vendosur kazanët e kuzhinës. Kushtet e përgjithshme të këtyre ambienteve u vlerësuan si jo të kënaqshme. Sipas informatave të ofruara nga stafi i kuzhinës, institucioni posedon dy mikserë të rinj dhe një furrë të re. Megjithatë, furra ka kapacitet vetëm për 250 bukë, ndërsa për pjesën tjetër të të burgosurve buka sigurohet përmes furnizimit nga operatori ekonomik. Kuzhina ishte e pajisur edhe me mjete të tjera të nevojshme, përfshirë gjashtë (6) kazanë funksionalë dhe shtatë (7) frigoriferë komorë, dy prej të cilëve ishin jashtë funksionit. Ekipi monitorues u njoftua se stafi i kuzhinës ka paraqitur kërkesë për sigurimin e mjeteve dhe pajisjeve shtesë që mungojnë, të planifikuara për vitin e ardhshëm.

32. Personeli i angazhuar në kuzhinë është i pajisur mjaftueshëm me dorëza njëpërdorimshme, mirëpo nuk është pajisur me uniforma pune prej dy vitesh.

33. MKP-ja, gjatë vizitës, u njoftua nga personeli se furnizimi me mish realizohet një herë në javë nga operatori, ndonëse kërkesa për furnizim bëhet dy herë në javë. Në rastet kur konstatohet cilësi e dobët e mishit, komisioni i përbërë nga tre anëtarë, të cilët e kontrollojnë cilësinë e tij, shpeshherë detyrohet t'ia kthejë mishin kompanisë furnizuese.

34. U konstatua se ashensori në depon e kuzhinës është funksional, mirëpo ende nuk është rinovuar dhe nuk funksionon rregullisht. Aktivizimi i tij bëhet në mënyrë mekanike, përmes motorit dhe me dorë, për shkak të mosfunksionimit të sistemit elektronik. Kjo gjendje paraqet rrezik për personat e angazhuar në bartjen e ushqimit dhe, sipas informacioneve të marra, ky problem ekziston prej disa vitesh.

35. Edhe hapësirat sanitare (banjat) në kuadër të kuzhinës janë jofunksionale. Për pasojë, personeli i angazhuar në kuzhinë nuk ka mundësi të realizojë në mënyrë të përshtatshme pastrimin dhe të kujdeset për higjienën personale gjatë punës.

36. Ekipi i MKP-së, gjatë monitorimit në QKD-së, vizitoi edhe ambientet e lavanderisë dhe u njoftua se është eliminuar problemi i mëhershëm i rrjedhjes së ujit nga tavani, i cili ndikonte në dëmtimin e pajisjeve të lavanderisë. Në lavanderi ishin të angazhuar tre persona të dënuar dhe një zyrtar. Sipas pohimeve të tyre, kishte mungesë të pajisjeve funksionale për larje dhe tharje, duke pasur parasysh kapacitetin e madh dhe fluksin e lartë të punës. Në ambientet e lavanderisë ishin gjithsej katër (4) makina larëse, prej të cilave dy ishin jashtë funksionit, si dhe pesë (5) makina tharëse, prej të cilave dy ishin jashtë funksionit. Personat e dënuar ishin të angazhuar në punë në lavanderi pesë ditë në javë. Sipas stafit përgjegjës, furnizimi me material higjienik realizohet në mënyrë të rregullt. Për sa u përket kushteve të përgjithshme higjieno-sanitare, u vërejt se objekti i lavanderisë ishte i vjetër. Megjithatë, ishin ndërmarrë masa për mirëmbajtjen e tij, përfshirë gëlqerosjen e mureve. Sipas stafit përgjegjës, pritet edhe zëvendësimi i dyerve në ambientet e lavanderisë.

Regjimi

37. Në kuadër të QKD-së funksionojnë tri punëtori, të cilat shërbejnë edhe si qendra për zhvillimin e trajnimeve profesionale. Në Punëtorinë nr. 1 organizohen trajnime në fushën e zdrukthëtarisë, të cilat zhvillohen në dy grupe gjatë vitit, me kohëzgjatje prej tre muajsh për secilin grup. Aktualisht, trajnimin në këtë fushë janë duke e ndjekur 10 persona të dënuar. Në ambientet e kësaj punëtorie janë të angazhuar një instruktor dhe tre persona të dënuar, të cilët merren me mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kryejnë ndërhyrjet e nevojshme, sipas kërkesave të paraqitura. Pas përfundimit të trajnimit, personat e dënuar pajisen me certifikatë dhe, sipas dëshirës, angazhohen në punë në fushën për të cilën janë trajnuar.

38. Në Punëtorinë nr. 2 organizohen trajnime profesionale për axhustatorë-saldues (metalpunues) dhe hidraulikë. Aktualisht, në këto trajnime janë të angazhuar nga 10 persona të dënuar. Pas përfundimit të trajnimit, personat e dënuar kanë mundësi të angazhohen në punë në kuadër të punëtorisë, sipas nevojave dhe mundësive, dhe për punën e kryer kompensohen në përputhje me rregullat dhe procedurat në fuqi.

39. Në Punëtorinë nr. 3 organizohen trajnime profesionale për muratorë. Në kuadër të kësaj punëtorie, 4 persona të dënuar angazhohen edhe në punët e saldimit dhe, sipas nevojës, në punë nëpër pavijone. Aktualisht, trajnimin profesional për muratorë janë duke e ndjekur 4 persona të dënuar.

40. MKP-ja konstatoi se në të gjitha punëtoritë kishte mungesë të materialeve të nevojshme për zhvillimin e punës dhe realizimin e trajnimeve profesionale. Po ashtu, edhe pse janë realizuar renovime të kulmeve të punëtorive, gjatë reshjeve të shiut ende paraqiten rrjedhje të ujit nga kulmet. Për sa u përket temperaturave të ulëta në ambientet e punëtorive, u njoftuam se ky problem është në proces të zgjidhjes përmes ristrukturimit të klasave dhe përmirësimit të kushteve në këto ambiente, pasi puna në to vështirësohet dhe nuk mund të zhvillohet në mënyrë të rregullt.

41. Në kuadër të Qendrës funksionon edhe punëtoria e rrobaqepësisë, në të cilën është i angazhuar një rrobaqepës, ndërsa, sipas nevojës, angazhohet edhe një person i dënuar. U konstatua se punëtoria është e pajisur me mjetet dhe pajisjet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë. Punëtoria posedon dy makina industriale për qepje, një pajisje për mbishtresim (overlock), si dhe një pajisje për hekurosje. Gjatë vizitës u vërejt se kishte sasi të mjaftueshme të materialeve të nevojshme për punë. Në këtë punëtori kryesisht qepen çarçafë, këllëfë për jastëkë, jelekë për të burgosur, si dhe pjesë të uniformave, të cilat përdoren për nevojat e Qendrës.

42. Neni 68 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale[11] shprehimisht përcakton: *"Personi i dënuar i aftë për punë ka të drejtë dhe obligim të punojë dhe mund të angazhohet me punë në punëtoritë e njësive ekonomike në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës."*

43. Në kuadër të monitorimit në Qendrën Korrektuese në Dubravë (QKD) është vizituar edhe shkolla që funksionon brenda institucionit, ku aktualisht në procesin arsimor janë të përfshirë 57 nxënës, të organizuar në klasat X, XI dhe XII. Gjatë monitorimit u konstatua

[11] Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 68, paragrafi 1.

se nuk ka persona të dënuar të përfshirë në procesin arsimor që nuk dinë shkrim-lexim. Në procesin arsimor janë të angazhuar një profesor koordinator dhe tetë profesorë të tjerë.

44. Në kuadër të shkollës gjendet edhe biblioteka, e cila është funksionale dhe shfrytëzohet nga personat e privuar nga liria. U evidentua se të burgosurit shfaqin interesim të mjaftueshëm për shfrytëzimin e bibliotekës dhe të materialeve të saj.

45. Në dispozicion të të burgosurve në QKD është edhe salla e sportit, e cila është funksionale dhe shfrytëzohet rregullisht nga personat e privuar nga liria. Për mbarëvajtjen dhe mbështetjen e aktiviteteve sportive janë të angazhuar katër instruktorë. Gjatë ditëve të punës, sallën e frekuentojnë rreth 150 persona në ditë, ndërsa gjatë fundjavës frekuentimi është më i lartë. Salla e sportit shfrytëzohet edhe nga nxënësit e shkollës që funksionon brenda Qendrës, të cilët kanë qasje në të dy herë në javë.

46. Qendra organizon edhe aktivitete të ndryshme sportive dhe turnirë, përfshirë futbollin, volejbollin, pingpongun dhe shahun, duke u mundësuar personave të privuar nga liria të marrin pjesë në aktivitete rekreative dhe sportive.

47. Salla e fitnesit është ndër hapësirat më të frekuentuara. Në këtë drejtim, u theksua nevoja për sigurimin e pajisjeve shtesë për ushtrime fizike, veçanërisht të një pajisjeje për ecje (treadmill), me qëllim të zgjerimit të mundësive për aktivitet fizik.

48. Gjatë monitorimit u ngrit shqetësimi lidhur me gjendjen e fushës së jashtme të futbollit, e cila ka sipërfaqe me bar artificial dhe është e dëmtuar në disa pjesë. Si pasojë e kësaj gjendjeje, janë shkaktuar edhe lëndime te personat që e shfrytëzojnë. Për këtë arsye, gjendja e fushës paraqet një çështje që kërkon vëmendje, veçanërisht nga aspekti i sigurisë së personave gjatë zhvillimit të aktiviteteve sportive.

Kujdesi shëndetësor

49. Neni 42 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: *"Personi i dënuar duhet të gëzoj të njëjtat standarde të kujdesit shëndetësor të cilat janë në dispozicion në komunitet."*[12]

50. Shërbimi shëndetësor në Qendrën Korrektuese në Dubravë (QKD) ofrohet 24 orë në ditë. Në kuadër të këtij shërbimi janë të angazhuar 7 mjekë me orar të rregullt, 10 mjekë konsulentë që ofrojnë shërbime një herë në javë, 1 mjek stomatolog, i cili angazhohet nga qendrat e tjera korrektuese, 2 psikologë me orar të plotë, 1 mjek psikiatër, 1 fizioterapeut, 1 farmacist dhe 19 infermierë me orar të rregullt, nga ora 8:00 deri në 16:00. Aktualisht janë të angazhuar 10 specialistë, përkatësisht: kardiologu, neurologu, pulmologu, kirurgu i përgjithshëm, fiziatri, specialisti i ORL-së dhe oftalmologu, ndërsa ortopedi për tash për tash nuk është duke ofruar shërbime. Rastet që nuk mund të trajtohen në spitalin e burgut marrin shërbime në institucionet e tjera publike shëndetësore.

51. Në Pavijonin D janë të punësuar 9 infermierë, 1 mjek i përgjithshëm, farmacistja, konsulentët, të cilët operojnë brenda burgut dhe ofrojnë shërbime një herë në javë, si dhe 1 psikolog klinik, i cili ofron shërbime tri herë në javë. Në momentin e vizitës së realizuar në muajin prill, në Krahun B (raste të vështira për t'u menaxhuar) ishin të vendosur 20 të dënuar, ndërsa në Krahun A ishin të vendosur 19 të dënuar. Gjatë vizitës së realizuar në muajin shtator, në Krahun B ishin të vendosur 15 të dënuar, ndërsa në Krahun A ishin të

[12] Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 42, paragrafi 1.

vendosur 18 të dënuar, prej të cilëve 13 raste të vështira për t'u menaxhuar. Ekipi i MKP-së ka realizuar disa intervista për t'u njohur më për së afërmi me trajtimin dhe kushtet që ofron Pavijoni D. Të dënuarit e vendosur në këtë pavijon u shprehën të kënaqur me trajtimin, kushtet dhe shërbimet mjekësore që ofrohen aty.

52. Për sa u përket kushteve në spitalin e QKD-së, MKP-ja vërejti se në hapësirat e spitalit janë kryer punime të gëlqerosjes, ndërsa është planifikuar edhe zëvendësimi i të gjitha dyerve.

53. MKP-ja vërejti se në Krahun J-1 të Spitalit të Qendrës Korrektuese në Dubravë ishin të akomoduar 12 persona me gjendje të rënda psikiatrike, ndërsa në Krahun V-2 ishin të akomoduar 17 persona me sëmundje kronike. Gjatë intervistave me personat e privuar nga liria dhe me stafin u ngritën shqetësime lidhur me temperaturat e larta gjatë muajve të verës, veçanërisht në katin e dytë.

54. Gjatë vizitës së realizuar më 7 maj 2026, MKP-ja shqyrtoi dosjet shëndetësore të personave të akomoduar në spital dhe konstatoi se ato ruheshin në mënyrë konfidenciale dhe se qasje në to kishte vetëm stafi shëndetësor.

55. Në kuadër të vlerësimit u shqyrtua dosja shëndetësore e pacientit D. P., rezident i Burgut të Sigurisë së Lartë (BSL), i cili ishte transferuar në QKD me qëllim të realizimit të seancave të fizioterapisë pas një aksidenti vaskular cerebral (AVC). Sipas dokumentacionit mjekësor, më 27.4.2026 pacienti kishte pësuar AVC dhe stafi i Burgut të Sigurisë së Lartë e kishte transferuar në emergjencë në QKUK. Aty, pacienti ishte konsultuar me specialistin e neurologjisë dhe, pas vlerësimit, ishte hospitalizuar në Klinikën e Neurologjisë për trajtim dhe vlerësim të mëtejshëm. Gjatë qëndrimit në klinikë, pacienti kishte marrë trajtimin e nevojshëm dhe, më 30.4.2026, ishte transferuar përsëri në BSL. Specialisti i neurologjisë i kishte rekomanduar pacientit terapi fizikale, kontrolle ambulatore te kardiologu, si dhe kontrolle neurologjike pas një muaji ose më herët, sipas nevojës. Për realizimin e terapisë fizikale, pacienti ishte transferuar në Burgun e Dubravës më 4.5.2026, ku kishte filluar seancat fizioterapeutike. Pas përfundimit të 10 seancave të fizioterapisë, stafi mjekësor kishte referuar se pacienti do të rikthehej në ambientet e BSL-së. Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezultoi se gjatë kësaj periudhe gjendja e pacientit ishte stabile, nuk ishin evidentuar komplikime dhe çdo seancë fizioterapeutike ishte dokumentuar në kartelën mjekësore.

56. Gjatë vizitës u konstatua se Qendra posedon infrastrukturë funksionale shëndetësore, e cila përfshin ambulancën, stacionarin, laboratorin funksional, farmacinë, dhomën stomatologjike, dhomën e ekzaminimeve me rreze X, dhomën e ortopedisë dhe dhomën e fizioterapisë. Institucioni gjithashtu posedonte karroca për personat me vështirësi në lëvizje.

57. Furnizimi me barna në institucion realizohet dy herë në vit, ndërsa, kur paraqitet nevoja, bëhet edhe më shpesh. Gjatë vlerësimit u konstatua se 100% e barnave të nevojshme, të përfshira në listën esenciale dhe që janë në kompetencë të institucionit, ishin në dispozicion. Përjashtim bëjnë barnat jashtë listës esenciale, të cilat sigurohen përmes procedurave përkatëse ose nga familjarët, sipas kërkesës së personit. Të gjitha këto procedura janë të rregulluara me PSV. Barnat ruhen brenda afatit të përdorimit, ndërsa ato me afat të skaduar asgjësohen një herë në vit nga kompania e autorizuar.

58. Gjatë vizitës u konstatua se institucioni posedon protokolle të ndryshme, siç janë protokollet individuale të secilit mjek, protokolli i vdekjeve, protokolli i vetëvrasjeve,

protokolli i lëndimeve trupore, protokolli i vetëlëndimeve, protokolli i grevës së urisë dhe protokolli i abuzimeve seksuale.

59. Në bazë të evidencave në protokolle dhe njoftimeve të stafit, rreth 35 deri në 50 të burgosur vizitohen brenda ditës ose marrin shërbime të ndryshme shëndetësore. Për sa u përket rasteve psikiatrike, rreth 130 deri në 140 të burgosur janë në terapi psikiatrike, ndërsa 30 të burgosur janë në terapi me metadon.

60. MKP-ja kontrolloi të gjitha protokollet dhe, në bazë të evidencave, konstatoi se nga janari deri në shtator 2026 ishin evidentuar 50 raste të vetëlëndimit, 1 rast i vetëvrasjes, 7 raste të tentimvetëvrasjes, 42 raste të grevës së urisë dhe 60 raste të vendosjes nën përcjellje permanente. Rreth 97 raste ishin trajtuar përmes komisioneve. Ky numër ishte rritur për shkak se çdo i burgosur që kalon për trajtim në Pavijonin D i nënshtrohet vlerësimit nga komisioni dhe jo vetëm rekomandimit të mjekut. Vizitat sistematike kryhen një herë në muaj.

61. Gjatë vizitës në QKD, ekipi i MKP-së nuk ka marrë ankesa nga të burgosurit lidhur me mungesën e barnave, pasi furnizimi me to ishte i mjaftueshëm. Ankesat kryesisht kishin të bënin me mundësinë e ofrimit të shërbimeve shëndetësore jashtë burgut.

62. Neni 34 i Udhëzimit Administrativ MD – NR. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese përcakton: *"I burgosuri, referohet në stacionarin e burgut, institucionin për trajtimin e personave me nevoja të veçanta ose në institucione të kujdesit shëndetësor publik sipas indikacioneve dhe rekomandimeve të mjekut."*[13]

63. Për sa u përket të dënuarve me masë disiplinore të vetmisë, MKP-ja ka vërejtur se personeli mjekësor nuk merr pjesë në vendimmarrjen për shqiptimin e masës disiplinore ndaj të burgosurit, por vetëm raporton për gjendjen shëndetësore të të burgosurve në fjalë. Bazuar në dokumentacionin përkatës, mjeku e viziton çdo dy deri në tri ditë të burgosurin ndaj të cilit është shqiptuar masa disiplinore e vetmisë, ndërsa infermieri e viziton së paku një herë në ditë dhe kujdeset për parametrat vitalë.

Shërbimi social në QKD

64. Gjatë vizitave në QKD, ekipi i MKP-së pranoi disa ankesa lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale dhe qasjen në to përmes zyrtarëve socialë. Në lidhje me këtë çështje, MKP-ja u informua se zyrtarët socialë kanë nën mbikëqyrje një numër të konsiderueshëm të personave të privuar nga liria. Përveç ofrimit të shërbimeve sociale, zyrtarët socialë angazhohen edhe në vizita në terren, përfshirë vizitat te familjarët e personave të privuar nga liria, me qëllim të mbledhjes së të dhënave dhe përgatitjes së raporteve për programet rehabilituese dhe Programin e Lirimit me Kusht (PLK).

65. Në kuadër të vizitës, MKP-ja u informua se në QKD aktualisht janë të angazhuar gjithsej 12 zyrtarë socialë, prej të cilëve 2 janë të angazhuar në programet rehabilituese, ndërsa, sipas strukturës organizative/rregullores përkatëse, janë të parapara gjithsej 20 pozita për zyrtarë socialë. Kjo paraqet mungesë të zyrtarëve socialë në raport me numrin e pozitave të parapara, çështje e cila mund të ndikojë në ngarkesën e punës dhe në kapacitetin për ofrimin e shërbimeve sociale dhe rehabilituese për personat e privuar nga liria.

[13] Udhëzim Administrativ MD – NR. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 34, paragrafi 2.

Kontakti me botën e jashtme

66. Në QKD, të dënuarit gëzojnë të drejtën e pakufizuar për korrespodencë. Personat e dënuar gëzojnë të drejtën edhe për telefonata, varësisht nga regjimi në të cilin ndodhen, kurse në disa pavijone telefonatat janë të pakufizuara. Lidhur me të drejtën telefonike, neni 59 i LESP-së[14] përcakton: *"Personi i dënuar ka të drejtë të bëjë thirrje telefonike dhe të komunikoj në forma të tjera të komunikimit elektronik."*

67. Në rastin e të paraburgosurve, neni 52 i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese përcakton: *"Të paraburgosurit thirrjet telefonike i mundësohen në bazë të lejes së gjykatës për numrat përkatës në përputhje me tretmanin standard."*[15]

68. Personat e dënuar gëzojnë të drejtën edhe për vizita familjare. Neni 61 i LESP-së[16] përcakton: *"Personi i dënuar ka të drejtë në pranimin e vizitave së paku një herë në muaj në kohëzgjatje prej së paku një (1) orë nga bashkëshorti/ja, fëmija, fëmija i adoptuar, prindi, prindi adoptues dhe të afërmit e tjerë të gjakut në vijë të drejtpërdrejtë ose në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt."*

69. Në rastin e personave të paraburgosur, komunikimi me personat e tjerë, përfshirë kontaktet me familjarët dhe personat e tjerë të autorizuar, realizohet në përputhje me kushtet dhe kufizimet e përcaktuara me ligj dhe me vendimin e gjykatës përkatëse. Sipas nenit 197 të Kodit të Procedurës Penale[17]: *"Me leje të gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues dhe nën mbikëqyrjen e ndonjë personi të caktuar nga gjyqtari i tillë, i paraburgosuri mund të vizitohet nga anëtarët e familjes, siç definohet në Kodin Penal dhe me kërkesë të tij mund të vizitohet nga mjeku apo nga persona të tjerë, duke respektuar rregullat e institucionit të paraburgimit."*

70. Neni 42 i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese[18] përcakton: *"Të burgosurit mund të vizitohen edhe nga personat zyrtar të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi."*

71. Personi i paraburgosur dhe ai i dënuar mund të kontaktojë me avokatin e tij pa kufizim dhe pa mbikëqyrjen e përmbajtjes së korrespondencës. Neni 197 i Kodit të Procedurës Penale[19] përcakton: *"Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund t`i vizitojnë të paraburgosurit dhe të korrespondojnë me ta pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, të gjyqtarit të vetëm gjykues apo të kryetarit të trupit gjykues ose të peronave të tjerë të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit. Komunikimi ndërmjet të paraburgosurit dhe Avokatit të Popullit ose përfaqësuesve të tij mund të shikohet nga zyrtari i policisë, por jo të dëgjohet."* Po ashtu, të dënuarit mund t'i drejtohen Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës (MKP) të Avokatit të Popullit edhe përmes telefonit.

[14] Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 59, paragrafi 1.
[15] Udhëzim Administrativ MD – NR. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 52, paragrafi 6.
[16] Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 61, paragrafi 1.
[17] Kodi nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, neni 197, paragrafi 1.
[18] Udhëzim Administrativ MD – NR. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 42, paragrafi 3.
[19] Kodi nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, neni 197, paragrafi 3.

72. Neni 40 i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese[20] përcakton: *"Korrespodenca e të burgosurit me Avokatin e Popullit të Kosovës është e privilegjuar që do të thotë se nuk duhet të kontrollohet në asnjë mënyrë."*

73. Më tej ky udhëzues përcakton se Avokati i Popullit ka të drejtë korrespodence me të paraburgosurin ose me të dënuarin në çdo kohë dhe pa paralajmërim.

74. Në rastin e shtetasve të huaj, neni 31 i LESP-së[21] përcakton: *"Shtetasit të huaj i ofrohet mundësia që me shkrim ose me telefon ta kontaktojë përfaqësuesin diplomatik apo zyrën përkatëse të shtetit, shtetësinë e të cilit e ka ai."*

75. Gjatë vizitës monitoruese janë pranuar ankesa nga personat e privuar nga liria lidhur me vështirësitë dhe pengesat në realizimin e thirrjeve telefonike përmes operatorit Vala. Sipas ankesave të pranuara, këto pengesa kanë ndikuar në mundësinë e tyre për të komunikuar rregullisht me familjarët dhe personat e tjerë jashtë institucionit. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit ka ndërmarrë disa veprime dhe ka zhvilluar komunikime përkatëse me institucionet përgjegjëse, me qëllim të adresimit të pengesave të evidentuara në komunikimin telefonik.

76. Për sa u përket shtetasve të huaj, të cilët janë duke vuajtur dënimin në QKD, atyre u mundësohet komunikimi me familjarët e tyre përmes platformës TEAMS. E njëjta mundësi u ofrohet edhe të burgosurve shtetas të Republikës së Kosovës, të cilët i kanë familjet jashtë shtetit, si dhe të burgosurve që nuk kanë mundësi të realizojnë vizita familjare. Komunikimi përmes platformës TEAMS u mundësohet këtyre kategorive për një kohëzgjatje prej 30 minutash për secilin të burgosur.

Hapësirat ku pranohen vizitat

77. Gjatë vizitës, MKP-ja vizitoi edhe hapësirat ku zhvillohen vizitat familjare, duke kaluar nëpër tunel nga porta e hyrjes së vizitorëve deri te perimetri i burgut.

78. Sipas informatave të ofruara gjatë vizitës, stafi i angazhuar në këto hapësira përbëhet nga 12 zyrtarë, 1 udhëheqës dhe 1 mbikëqyrës. Nga numri i përgjithshëm i zyrtarëve, katër janë femra dhe tetë meshkuj. Stafi ka theksuar nevojën për shtimin e së paku tre zyrtarëve, veçanërisht për të siguruar mbulimin e nevojshëm gjatë periudhave të pushimeve. Sipas tyre, numri minimal i zyrtarëve që duhet të jenë të angazhuar është nëntë.

79. Për sa u përket kushteve në hapësirat e vizitave, ato u vlerësuan si të kënaqshme. Ekipi vizitoi edhe dhomat e vizitave të lira dhe vërejti se ato ishin gëlqerosur gjatë vitit të kaluar. Stafi e njoftoi ekipin se përballet me probleme të shpeshta me detektorët e dorës, të cilët prishen në mënyrë të përsëritur. Ndërkaq, skaneri i instaluar në këto hapësira është i ri dhe është siguruar përmes donacionit të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

80. Gjatë vizitës u konstatua se objekti është i vjetër dhe ka probleme të theksuara me lagështinë, për shkak të së cilës nuk i plotëson në tërësi kushtet e nevojshme për funksionimin e përshtatshëm të këtyre hapësirave. Kamerat e sigurisë të instaluara në këto hapësira ishin funksionale.

81. Gjithashtu, ekipi vizitoi edhe dy sallat e vizitave. Njëra sallë është më e madhe dhe shfrytëzohet për zhvillimin e 13 vizitave, ndërsa salla tjetër ka kapacitet për nëntë vizita

[20] Udhëzim Administrativ MD – NR. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 40, paragrafi 1.
[21] Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 31, paragrafi 4.

dhe shfrytëzohet edhe për sjelljen e pakove ushqimore, pra është e paraparë për nëntë familje.

82. Stafi ka shprehur nevojën për sigurimin e një mjeti transportues për vizitorët, pasi transporti i tyre nga porta kryesore deri te sallat e vizitave bëhet me një kombi/minibus, i cili është shumë i vjetër dhe i amortizuar.

Çështje të ndërlidhura me sigurinë (Dhoma e Kontrollit)

83. Gjatë vizitës në Dhomën e Kontrollit, MKP-ja vërejti se kjo hapësirë është e pajisur me gjithsej 419 kamera të sigurisë, të cilat ishin funksionale. Numri i madh i kamerave paraqet ngarkesë të konsiderueshme për stafin, veçanërisht duke pasur parasysh numrin e kamerave që duhet të monitorohen dhe nevojën për reagim në kohë ndaj çdo situate të dyshimtë. Në zyrën e monitorimit të kamerave janë të angazhuar tre zyrtarë, të cilët e monitorojnë sistemin në intervale kohore, përkatësisht duke kontrolluar kamerat çdo dy orë. Megjithatë, janë evidentuar vështirësi objektive për monitorimin efektiv dhe të vazhdueshëm të të gjitha kamerave nga një zyrtar, për shkak të numrit të madh të kamerave dhe vëllimit të informacionit vizual që duhet të përpunohet. Po ashtu, është raportuar se herë pas here paraqiten ndërprerje të lidhjes së internetit, të cilat ndikojnë në funksionimin e rregullt të sistemit të monitorimit dhe në vazhdimësinë e mbikëqyrjes.

84. Ekipi u njoftua se nga institucioni është kërkuar instalimi i kamerave të sigurisë edhe në hapësira të tjera, përfshirë fermat 1 dhe 2, si dhe fermën e pulave, të cilat nuk janë të mbuluara me sistem kamerash. Ekipi monitorues u njoftua se, prej një periudhe të caktuar, nuk janë sjellë në institucion kafshë të konfiskuara nga autoritetet doganore.

85. Sipas Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT), sistemet e kamerave të sigurisë përbëjnë një nga garancitë për mbrojtjen nga keqtrajtimi të personave të privuar nga liria, por, njëkohësisht, mund të shërbejnë edhe si garanci për zyrtarët korrektues në rastet kur ndaj tyre ngrihen akuza të pabazuara.[22]

86. Ekipi vërejti se Dhoma e Kontrollit ishte furnizuar me inventar të ri, përfshirë karrige dhe kompjuterë. Gjithashtu, u njoftua se është në proces furnizimi me pajisje për klimatizim, pasi në zyrën e sigurisë ishte ngritur shqetësim lidhur me nivelin e zhurmës së shkaktuar nga njëra prej pajisjeve të klimatizimit, e cila, sipas stafit, prodhon zhurmë të konsiderueshme që ndikon në përqendrimin e zyrtarëve gjatë ushtrimit të detyrave.

87. Në Dhomën e Kontrollit janë të angazhuar gjithsej 25 zyrtarë, prej të cilëve 6 janë femra. Në këtë njësi, për shkak të natyrës së ndjeshme të punës që kryhet në këtë hapësirë, stafi përzgjidhet në mënyrë të veçantë, kryesisht duke u bazuar në përvojën e punës dhe mungesën e masave disiplinore të evidentuara.

88. Stafi operativ angazhohet sipas sistemit të punës 2+2, me ndërrime nga 12 orë, ndërsa udhëheqësi i njësisë punon me orar të rregullt prej 8 orësh.

Sektori i Armatimit

89. MKP-ja vizitoi edhe objektin e ish-gjykatës, ku aktualisht është i vendosur Sektori i Armatimit, Arkivi, Njësia e Transportit dhe Depoja.

[22] KPT-ja, Raporti për vizitën në Irlandë në vitin 2010, paragrafi 18.

90. Në Sektorin e Armatimit aktualisht janë të angazhuar pesë zyrtarë. Gjatë vizitës, MKP-ja konstatoi se poligoni i qitjes është në gjendje të papërshtatshme. Në poligon mungon shtresa e zallit, nuk ka furnizim me ujë dhe mungojnë hapësirat sanitare. Këto kushte vështirësojnë realizimin e ushtrimeve dhe trajnimeve të nevojshme për zyrtarët e këtij sektori.

91. Në lidhje me pajisjet mbrojtëse, zyrtarët e Sektorit të Armatimit informuan për mungesën e jelekëve antiplumb. Sipas informatave të dhëna, jelekët antiplumb, që aktualisht janë në dispozicion, e kanë afatin e përdorimit të skaduar. Zyrtarët theksuan nevojën që secili zyrtar të pajiset me jelek antiplumb të personalizuar, në mënyrë që pajisja mbrojtëse t'i përshtatet individualisht dhe të mos përdoret nga disa zyrtarë.

92. Një tjetër çështje e ngritur gjatë vizitës ishte mungesa e radiolidhjeve. Sipas zyrtarëve, mungesa e pajisjeve të komunikimit paraqet vështirësi në komunikimin dhe koordinimin gjatë kryerjes së detyrave të tyre, veçanërisht gjatë aktiviteteve që kërkojnë reagim të shpejtë dhe koordinim të menjëhershëm.

93. Lidhur me armatimin, MKP-ja u informua se furnizimi me armë sigurohet nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa certifikimi kryhet nga Policia e Kosovës. Sipas zyrtarëve të Sektorit të Armatimit, ricertifikimi i armatimit nuk është kryer prej rreth tri vjetësh, ndërkohë që, sipas informatave të dhëna, vlefshmëria e certifikimit është nga 8 deri në 14 muaj. Kjo çështje kërkon verifikim të mëtejshëm lidhur me statusin e certifikimit të armatimit dhe respektimin e kërkesave përkatëse të sigurisë.

94. Në depon e armatimit janë të vendosura arka të posaçme për ruajtjen e armëve. Depoja është e mbikëqyrur përmes kamerave të sigurisë.

95. Zyrtarët e Sektorit të Armatimit ngritën shqetësim edhe lidhur me vendosjen e tyre në pavijone. Sipas tyre, duke marrë parasysh natyrën dhe përgjegjësitë e veçanta të punës, vendosja e zyrtarëve të këtij sektori në pavijone nuk është e përshtatshme dhe mund të paraqesë rrezik për sigurinë e tyre dhe për ushtrimin e detyrave.

96. Gjatë monitorimit u vizitua edhe depoja e Qendrës, në të cilën kryesisht ruhen sende dhe materiale të cilat janë konstatuar si të panevojshme ose të tepërta gjatë kontrolleve dhe bastisjeve të qelive.

Njësiti i Transportit

97. Njësiti i Transportit ka gjithsej 48 zyrtarë. Sipas mbikëqyrësit të njësitit, aktualisht janë në dispozicion 11 automjete për transport, ndërsa për përmbushjen e nevojave të njësitit nevojiten së paku edhe 11 automjete të tjera.

98. Gjatë vizitës u evidentua se një pjesë e automjeteve të transportit janë të amortizuara. Gjithashtu, sipas informatave të dhëna nga Njësiti i Transportit, disa prej automjeteve që aktualisht janë në përdorim nuk i plotësojnë kriteret e nevojshme për transportimin e personave të privuar nga liria.

99. MKP-ja vlerëson se gjendja e automjeteve dhe mungesa e numrit të mjaftueshëm të mjeteve të transportit mund të ndikojnë në realizimin e sigurt dhe efikas të transportit të personave të privuar nga liria.

Njësiti K -9

100. Gjatë vizitës, MKP-ja u informua se në Njësitin K9 aktualisht janë të angazhuar dy zyrtarë dhe dy qen, të trajnuar për zbulimin e substancave narkotike. Sipas informatave të dhëna, qentë janë trajnuar nga Policia e Kosovës.

101. Ekipi u informua se Njësiti K9, sipas nevojës, mund të angazhohet nga Shërbimi Korrektues i Kosovës edhe në qendrat e tjera korrektuese dhe të paraburgimit. Sipas strukturës së paraparë, ky njësit duhet të përbëhet nga gjithsej tetë zyrtarë. Gjithashtu, ekipi u informua se janë duke u zhvilluar bisedime me EULEX-in për forcimin e mëtejshëm të këtij njësiti.

102. Sipas zyrtarëve të Njësitit K9, ekziston nevoja për sigurimin e një automjeti të posaçëm për transportimin e qenve, me qëllim të mundësimit të transportit të tyre në mënyrë të përshtatshme dhe të sigurt gjatë angazhimeve në Qendrën Korrektuese në Dubravë dhe në institucionet e tjera korrektuese dhe të paraburgimit.

Njësia e Zjarrfikësve

103. Në kuadër të Qendrës funksionon Njësia e Zjarrfikësve, e cila është e organizuar për të reaguar në rast zjarri dhe në situata të tjera që kërkojnë ndërhyrje emergjente. Në Njësinë e Zjarrfikësve janë të angazhuar gjashtë zjarrfikës gjatë ditës dhe një zjarrfikës gjatë natës, duke siguruar mbulimin e nevojshëm në vazhdimësi.

104. Njësia e Zjarrfikësve, sipas nevojës, kryen edhe ndërhyrje nëpër qelitë e Qendrës, veçanërisht në rastet kur paraqiten situata që kërkojnë asistencë ose ndërhyrje të menjëhershme. Për kryerjen e këtyre ndërhyrjeve, njësia disponon materialet dhe pajisjet e nevojshme.

Personeli i Qendrës Korrektuese në Dubravë

105. Gjatë vizitës, MKP-ja ka pranuar ankesa të shumta nga zyrtarët korrektues lidhur me numrin e pamjaftueshëm të personelit në raport me numrin e personave të privuar nga liria, si dhe me kushtet e punës. Po ashtu, zyrtarët korrektues kanë shprehur shqetësime lidhur me mungesën e furnizimit me uniforma dhe çizme, kompensimin për rrezikshmëri, njohjen e stazhit të punës me beneficione, si dhe moshën e zyrtarëve dhe ndikimin e saj në ushtrimin e detyrave të tyre.

106. Në këtë drejtim, neni 20, paragrafi 3, si dhe neni 24, paragrafi 3, të Ligjit nr. 08/L-131[23] për Shërbimin Korrektues të Kosovës, përcaktojnë detyrimin për sigurimin e kushteve të sigurta dhe të shëndetshme të punës, si dhe të kushteve optimale për personelin korrektues.

Procedurat e ankesave

107. Personat e vendosur në burgje dhe në qendrat e paraburgimit duhet të kenë mundësi të parashtrojnë ankesa në këto institucione, ndërsa qasja te autoriteti përkatës duhet t'u mundësohet në mënyrë konfidenciale. Personat e dënuar njoftohen për të drejtat e tyre dhe për procedurat e paraqitjes së ankesave dhe kërkesave.

108. Neni 90 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: *"Në ankimin e paraqitur drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15)*

[23] Neni 20, paragrafi 3, dhe neni 24, paragrafi 3, të Ligjit nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jipet përgjigja në formën me shkrim."[24]

109. Gjatë vizitës në QKD, MKP-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit lidhur me mosdhënien e përgjigjes nga drejtori i QKD-së dhe i ShKK-së.

110. Në QKD, në dispozicion të të burgosurve janë kutitë e ankesave, të vendosura nga ShKK-ja, nga DShB-ja dhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesave.

Konstatimet e Avokatit të Popullit për Qendrën Korrektuese në Dubravë

111. Nga të gjeturat gjatë vizitës, Avokati i Popullit konstaton se në pavijone mungojnë njoftimet e dukshme për të drejtat dhe detyrimet e personave të burgosur.

112. Avokati i Popullit konstaton pretendime për përdorim të tepruar të forcës dhe sjellje të papërshtatshme nga personeli korrektues.

113. Avokati i Popullit konstaton se kushtet fizike dhe infrastrukturore në hapësirat ku mbahen personat e privuar nga liria, ndaj të cilëve është shqiptuar masa disiplinore e vetmisë, nuk janë të përshtatshme dhe kanë nevojë për përmirësim.

114. Avokati i Popullit konstaton se kushtet e banimit dhe ato higjieno-sanitare në QKD, në përgjithësi, janë të kënaqshme. Megjithatë, në disa pavijone vazhdojnë të ekzistojnë mangësi, veçanërisht në furnizimin me ujë të ngrohtë, në kushtet higjieno-sanitare dhe në cilësinë e dyshekëve dhe jastëkëve.

115. Avokati i Popullit konstatoi mangësi në infrastrukturën dhe funksionalitetin e kuzhinës dhe të lavanderisë, të cilat ndikojnë në kushtet e punës së personelit dhe në ofrimin e shërbimeve për personat e privuar nga liria. Mangësitë përfshijnë depërtimin e ujit nga tavani i kuzhinës, frigoriferët dhe pajisjet e lavanderisë jashtë funksionit, mungesën e uniformave të punës për personelin e kuzhinës, si dhe jofunksionalitetin e ashensorit.

116. Avokati i Popullit konstaton se institucioni ofron mundësi për zhvillimin e aktiviteteve, aftësimin profesional dhe shkollimin, përmes punëtorive, shkollës, bibliotekës dhe hapësirave sportive. Megjithatë, në punëtoritë profesionale është evidentuar mungesë e materialeve të nevojshme për zhvillimin e trajnimeve dhe të punës praktike, si dhe depërtimi i ujit nga kulmet dhe temperaturat e ulëta, të cilat e vështirësojnë zhvillimin e aktiviteteve. Po ashtu, dëmtimet në disa pjesë të fushës së futbollit rrezikojnë sigurinë e shfrytëzuesve, ndërsa salla e fitnesit ka nevojë për pajisje shtesë.

117. Avokati i Popullit konstaton se Qendra Korrektuese në Dubravë posedon infrastrukturë funksionale dhe kapacitete për ofrimin e kujdesit shëndetësor. Megjithatë, ekziston nevoja për përmirësimin e kushteve dhe sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve specialistike.

118. Avokati i Popullit konstaton se mungesa e zyrtarëve socialë dhe mbingarkesa me detyra administrative ndikojnë në ofrimin e shërbimeve sociale dhe rehabilituese për personat e privuar nga liria.

119. Avokati i Popullit konstaton se personat e dënuar në QKD gëzojnë të drejtën e korrespondencës dhe të telefonatave. Megjithatë, janë pranuar ankesa lidhur me pengesat

[24] Neni 90, paragrafi 4, i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

në realizimin e thirrjeve telefonike përmes operatorit Vala, të cilat pengojnë ushtrimin efektiv të së drejtës për komunikim me familjarët dhe personat e tjerë jashtë institucionit.

120. Avokati i Popullit konstaton se funksionimi i hapësirave për vizita familjare përballet me disa vështirësi, që lidhen me mungesën e personelit, gjendjen fizike të objektit dhe të pajisjeve, si dhe kushtet e transportit të vizitorëve.

121. Avokati i Popullit konstaton mangësi në kushtet e punës dhe në pajisjet mbrojtëse në Sektorin e Armatimit.

122. Avokati i Popullit konstaton se numri i pamjaftueshëm dhe amortizimi i automjeteve të transportit rrezikojnë realizimin e sigurt dhe efikas të transportit të personave të privuar nga liria.

123. Avokati i Popullit konstaton se mungesa e personelit dhe e një automjeti të posaçëm për transportimin e qenve kufizon kapacitetet operative të Njësitit K9.

124. Avokati i Popullit konstaton se mungesa e personelit dhe shqetësimet lidhur me kushtet e punës ndikojnë në ushtrimin e detyrave dhe në mirëqenien e zyrtarëve korrektues në QKD.

Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të MKP-së gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Drejtësisë:

1. Të vendosen njoftime të qarta dhe të mjaftueshme lidhur me të drejtat dhe detyrimet e personave të burgosur.
2. Çdo pretendim për keqtrajtim, përdorim të tepruar të forcës apo sjellje të papërshtatshme verbale nga personeli korrektues të shqyrtohet në mënyrë të paanshme, efektive dhe brenda një afati të arsyeshëm, si dhe të ndërmerren masat përkatëse në rastet kur konstatohen shkelje.
3. Të ndërmerren veprime për sigurimin e kushteve të jetesës për personat ndaj të cilëve është shqiptuar masa disiplinore e vetmisë, përfshirë furnizimin e rregullt me ujë të ngrohtë, si dhe respektimin e të drejtave minimale të garantuara me legjislacionin në fuqi.
4. Të ndërmerren masa konkrete për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të kushteve të banimit në të gjitha pavijonet, duke siguruar furnizim të rregullt me ujë të ngrohtë, kushte të përshtatshme higjieno-sanitare, eliminimin e pajisjeve elektrike të improvizuara dhe dyshekë e jastëkë cilësorë për të gjithë personat e privuar nga liria.
5. Të ndërmerren masa konkrete për mënjanimin e mangësive infrastrukturore dhe funksionale në kuzhinë dhe në lavanderi, duke siguruar renovimin e hapësirave, riparimin ose zëvendësimin e pajisjeve jofunksionale, funksionalizimin e ashensorit, si dhe pajisjen e personelit me uniforma pune.

6. Të ndërmerren masa për përmirësimin e kushteve në punëtoritë profesionale, duke siguruar materialet e nevojshme për zhvillimin e trajnimeve, sanimin e kulmeve dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve. Të bëhet sanimi i fushës së jashtme të futbollit për të garantuar sigurinë e shfrytëzuesve, si dhe të shqyrtohet mundësia për pajisjen e sallës së fitnesit me mjete shtesë për ushtrime fizike.
7. Të ndërmerren masa nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, në bashkëpunim me institucionet kompetente shëndetësore, për përmirësimin e kushteve në hapësirat e spitalit, duke siguruar temperaturë të përshtatshme gjatë gjithë vitit.
8. Avokati i Popullit ripërsërit rekomandimin që të ndërmerren masa për plotësimin e pozitave të parapara për zyrtarë socialë, me qëllim të garantimit të qasjes së rregullt të personave të privuar nga liria në shërbime sociale dhe rehabilituese.
9. Të ndërmerren masa për eliminimin e pengesave teknike në realizimin e thirrjeve telefonike në QKD, me qëllim të sigurimit të qasjes së rregullt dhe të mundësisë së komunikimit me familjarët.
10. Të ndërmerren masa për plotësimin e nevojave për personel në hapësirat e vizitave familjare, sanimin e lagështisë dhe përmirësimin e kushteve infrastrukturore të objektit, sigurimin e pajisjeve të kontrollit të sigurisë (detektorëve të dorës), si dhe zëvendësimin e minibusit të amortizuar me një mjet transporti të përshtatshëm dhe të sigurt për vizitorët.
11. Të ndërmerren masa për përmirësimin e kushteve në poligonin e qitjes, pajisjen e zyrtarëve me mjete mbrojtëse me afat të vlefshëm përdorimi dhe pajisje funksionale për komunikim, si dhe të bëhet verifikimi i statusit të certifikimit dhe ricertifikimit të zyrtarëve. Gjithashtu, të bëhet vlerësimi i rreziqeve që lidhen me vendosjen e zyrtarëve të Sektorit të Armatimit në pavijone.
12. Të ndërmerren masa për shtimin e numrit të automjeteve të Njësitit të Transportit dhe zëvendësimin e atyre të amortizuara, me qëllim të garantimit të transportit të sigurt dhe efikas.
13. Të ndërmerren masa për plotësimin e pozitave të parapara për Njësitin K-9 dhe sigurimin e një automjeti të posaçëm për transportimin e qenve.
14. Të ndërmerren masa për plotësimin e vendeve të nevojshme të punës, përmirësimin e kushteve dhe sigurimin e uniformave e pajisjeve të përshtatshme për zyrtarët korrektues.
15. Të organizohen trajnime për zyrtarët korrektues, me qëllim që ata të njoftohen me Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe me mandatin e MKP-së.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj*.") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të*

përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë."), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,
Naim Qelaj
Avokat i Popullit